VENDIM
Nr. 26, datë 22.12.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS URA VAJGURORE
(Ndryshuar me vendimin nr. 12, datë 23.2.2016)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1.Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor operatorit sh.a. Ujësjellës Ura Vajgurore, me:

Drejtues ligjor: Petref Sula

Drejtues teknik: Jolanda Gjordeni.

2.Operatori sh.a. Ujësjellës Ura Vajgurore, autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia: Ura Vajgurore
Komuna: Poshnje
Fshat: Pashalli
Hallvaxhias
Skrevan
Vokopol
Konizbaltë
Moravë

4. Kjo licencë është e vlefshme deri më dt. 7.9.2016, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR-së nr. 20, datë 7.9.2012.

KRYETARI
Avni Dervishi